

Gotech Sh.p.k

**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2017**

Përmbajtja	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE	4
1. Informacion i pergjithshem.....	5
2. Permbledhje e politikave kryesore kontabel.....	5
3. Politikat kontabel	6
4. Mjete monetare	9
5. Llogari te arketueshme tregtare	10
6. Te tjera llogari te arketueshme	10
7. Inventari.....	10
8. Aktive afatgjata materiale dhe jomateriale	11
9. Te tjera te drejta ndaj te treteve	12
10. Hua afatshkurtra dhe afatgjata	12
11. Arkëtime në avance për porosi.....	12
12. Llogari të pagueshme tregtare	13
13. Detyrime tatimore	13
14. Provizione	13
15. Te tjera te pagueshme	13
16. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	14
17. Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme.....	14
18. Shpenzime te tjera.....	14
19. Shpenzime te tjera te shfrytezimit	14
20. Te ardhura te tjera.....	14
21. Shpenzime financiare.....	14
22. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15
23. Angazhime dhe pasiguri	15
24. Ngjarje te mepasshme.....	15

GOTECH SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	25,500,580	25,731,872
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	310,780,491	207,295,012
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	3,600,498	4,692,806
Inventari	7	424,944,335	386,176,378
Total Aktive Afatshkurtra		764,825,904	623,896,068
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	19,503,579	15,230,640
Aktive afatgjata jomateriale	8	2,722,961	-
Te tjera te drejta ndaj te treteve	9	21,208,183	40,580,155
Total aktive afatgjata		43,434,723	55,810,795
Total Aktive		808,260,627	679,706,863
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	146,245,000	108,820,040
Arkëtime në avance për porosi	11	5,075,753	6,253,329
Llogari të pagueshme tregtare	12	390,010,129	325,782,820
Detyrime ndaj punonjesve		-	1,735,765
Detyrime tatimore	13	11,467,217	1,417,682
Provizione	14	2,714,347	-
Total Detyrime afatshkurtra		555,512,446	444,009,636
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	10	49,419,686	60,956,640
Te tjera te pagueshme	15	80,056,245	80,056,245
Total Detyrime afatgjata		129,475,931	141,012,885
Totali i detyrimeve		684,988,377	585,022,521
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		57,404,608	57,404,608
Rezerva ligjore		37,279,734	22,522,733
Fitimi vitit ushtrimor		28,587,908	14,757,001
Total kapitali themeltar		123,272,250	94,684,342
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		808,260,627	679,706,863

Këto pasqyra financiare dhe shënimet shoqëruese nga 1 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, janë aprovuar nga drejtimi dhe nënshkruar në emër të tij me 30 Mars 2018 nga:

Administrator

Bujar CEPALI



Financiere

Albana LUSHAJ

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	16	868,344,559	773,021,393
Te ardhura te tjera te shfrytezimit		-	2,442,864
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(716,313,948)	(650,877,936)
1) Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	17	(702,150,611)	(636,695,364)
2) Te tjera shpenzime	18	(14,163,337)	(14,182,572)
Shpenzime te personelit		(28,813,856)	(25,275,517)
1) Paga dhe shperblime		(24,688,857)	(21,700,122)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore (paraqitur			
2) vecmas nga shpenzimet per pension)		(4,124,999)	(3,575,395)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(3,860,110)	(3,458,821)
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	19	(81,124,834)	(74,658,759)
Te ardhura te tjera	20	3,942,157	3,976,357
Fitim /humbje nga kurset e kembimit		3,942,157	3,976,357
Shpenzime financiare	21	(8,032,478)	(7,629,051)
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme (paraqitur vecmas			
1) shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		(8,032,478)	(7,629,051)
Fitimi/humbja para tatimit		34,141,490	17,540,530
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	(5,553,582)	(2,783,529)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(5,553,582)	(2,783,529)
Fitimi/humbja e vitit		28,587,908	14,757,001
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		28,587,908	14,757,001

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

GOTECH SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva per investime	Fitim/(Humbja) i/e pashpërndarë	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	57,404,608	11,573,936	10,948,797	79,927,341
Fitimi i vitit	-	-	14,757,001	14,757,001
Transferim ne rezerva per investime	-	10,948,797	(10,948,797)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	57,404,608	22,522,733	14,757,001	94,684,342
Fitimi i vitit	-	-	28,587,908	28,587,908
Transferim ne rezerva per investime	-	14,757,001	(14,757,001)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	57,404,608	37,279,734	28,587,908	123,272,250

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

GOTECH SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit		28,587,908	14,757,001
Shpenzime financiare jomonetare			
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	20	5,553,582	2,783,529
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	3,860,110	3,458,821
Rënie/(rritje) në llogarite e arketueshme	5	(103,485,479)	(89,878,770)
Rënie/(rritje) në llogarite e tjera te arketueshme	6	1,092,308	(3,914,169)
Rënie/(rritje) në Inventar	7	(38,767,957)	(64,477,413)
Rënie/(rritje) në te tjera te drejta ndaj te treteve	9	19,371,972	(40,365,523)
Rënie/(rritje) në arkëtime në avance për porosi	11	(1,177,576)	(2,047,671)
Rritje/(rënie) në llogarite e pagueshme dhe detyrime te tjera	12	64,227,309	122,562,715
Rritje/(rënie) në detyrimet ndaj punonjeve		(1,735,765)	1,135,054
Rritje/(rënie) në detyrimet tatimore	13	7,567,158	(2,483,937)
Rritje/(rënie) në provizione	14	2,714,347	-
Tatim fitimi I paguar		(3,071,205)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(15,263,288)	(58,470,363)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	8	(11,147,727)	(3,651,312)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	8	291,717	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(10,856,010)	(3,651,312)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Hua të arkëtuara	10	38,010,960	71,948,137
Pagesa te huave	10	(14,786,744)	-
Te hyra të qirasë financiare	10	3,817,017	-
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	10	(1,153,227)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		25,888,006	71,948,137
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		(231,292)	9,826,462
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	4	25,731,872	15,905,410
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	25,500,580	25,731,872

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PERGJITHSEM

Shoqëria GOTECH Sh.p.k. (me poshte referuar si “Shoqëria”) është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit me date 07 janar 2009 dhe pranë Degës së Tatimeve dhe Taksave Tiranë me NIPT K91307509G. Shoqëria zotërohet nga ortakët Agron Duka, Bujar Cepeli dhe Armand Duka me pjesëmarrje perkatesisht 40%, 20% dhe 40% secili në kapitalin e Shoqërisë.

Me 31 dhjetor 2017, vlera e kapitalit themeltar është 57,404,608 Leke, e ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 574,046.08 Leke për kuota e ndarë sipas % të mesipërme të zotërimit të kapitalit.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat perkatese të Ligjit 9901, date 14 prill 2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe nga akti i themelimit dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është: Aktiviteti kryesor i shoqërisë është magazinimi dhe tregëtimim i mallrave industriale, kryesisht elektroshtepiake.

Administratori i Shoqërisë është Z. Bujar Cepeli

Selia kryesore e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Kashar, Autostrada Tiranë - Durrës Km. 0, mbikalimi i Kamzës, ndertesa ish Qendra Tregtare Casa Italia.

Numri i punonjësve të Shoqërisë me 31 dhjetor 2017 është 86.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombetare të Kontabilitetit (SKK) të shpallura me date 15 qershor 2006, të përmirësuara dhe të detyrueshme për zbatim për pasqyrat financiare që përgatiten pas 01 janar 2015, në përputhje me Ligjin 9228, date 29 prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” të ndryshuar, me ligjin 9477, date 9 shkurt 2006.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe, nëse ka të tilla.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare të ndërmjetme janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vleresime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabel të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varesi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente gjate periudhes per te cilen jane pergatitur keto pasqyra financiare te ndermjetme, perveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare te paraqitura ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehin ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdorura ne konvertimin e asetëve dhe detyrimeve monetare me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 jane:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Leke/Euro	132.95	135.23
Leke/Dollare Amerikan	111.10	128.17

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga llogari te arketueshme, mjete monetare dhe llogari te pagueshme dhe qeraja financiare.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne shpenzime dhe te ardhura. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiar joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Shoqerise mbi flukset e parase se aktivitetet financiar ose kur Shoqeria transferon aktivitetet financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivitetet. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase (mjetet monetare) perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellime te pasqyres se fluksit te parase, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijne llogarite rrjedhese dhe parane e gatshme ne arke.

Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme (kerkesat e arketueshme) njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjoni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose pagesa te vonuara konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metodën e interesit efektiv.

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat financiare (vazhdim)

Qeraja financiare dhe huate afatgjata

Qeraja financiare dhe huate afatgjata paraqitet me vleren e tyre të drejte dhe me pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Te tjera

Instrumenta të tjera joderivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

3.3 Inventaret

Inventaret përcaktohen me vlerën me të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera për përfitimin e inventarit dhe kosto të tjera të kryera për dërgimin e inventareve në destinacion dhe me kushtet e kerkuara. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që Shoqëria pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhjen normale të biznesit

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtëpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetegjatesi të ndryshme, ato kontabilizohen si zera të ndryshme (komponentet me të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpashme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zeri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabel të atij zeri nëse është e mundur që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke marrë për bazë jetën e dobishme të aktivitetit duke filluar nga dita kur ai është i gatshëm për përdorim.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Metodatat e amortizimit dhe përqindjet përkatëse sipas grupeve të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Permiresime në qiramarrje	5 % mbi vlerën kontabel neto
Mjete transporti	20% mbi vlerën kontabel neto
Makineri dhe pajisje	20% mbi vlerën kontabel neto
Pajisje informatike	25% mbi vlerën kontabel neto
Orendi dhe pajisje zyre	20% mbi vlerën kontabel neto
Software	25% mbi vlerën kontabel neto

Cëgjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çëgjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivitetit të zvogëluar me vlerën e tij të mbetur. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë zbritëse përgjatë jetës së aktivitetit. Shoqëria ka vetëm të drejtat e përdorimit të njohur në këto pasqyra financiare.

3.6 Zhvlerësimi

Aktivitet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rendesishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar të disponueshëm për shitje i njohur me parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitet jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktiviteti tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.7 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalese parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parase me një normë skontimi që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parase dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrese bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhjen normale të aktiviteteve të Shoqërisë që rezultojnë në rritje të kapitalit neto gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit neto në sajë të kontributeve të ortakeve. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arketuar apo të arketueshme nga shitja e mallrave dhe shërbimeve në rrjedhjen normale të aktiviteteve të Shoqërisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet, nëse ka.

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në varesi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostovë perkatese.

Të ardhurat nga shitja e automjeteve dhe shërbimet për riparime

Shoqëria siguron të ardhura nga shitblerja e automjeteve si dhe nga riparimet dhe shërbimet e mirembajtjes që i kryen atyre. E ardhura përbehet nga cmimi i marrë për shitjen dhe shërbimin kryer.

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.9 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë fitimet nga kursi i kembimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe të ardhura të tjera nga interesat e llogarive rrjedhëse apo depozitave. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për qerane financiare, humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet në vlerën e drejte të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nepermjet llogarise fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (31 dhjetor 2016: 15%).

4. MJETE MONETARE

Mjetet monetare përfaqësojnë llogaritë rrjedhëse që Shoqëria ka me bankat në Shqipëri si dhe paraja në arke në valute dhe në monedhe vendase. Më poshtë po ju japim një detajim të llogarive me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Para në bankë	21,337,579	9,329,006
Leke	19,934,220	9,004,271
Euro	1,274,132	264,798
USD	129,227	59,937
Para në arkë	4,163,001	16,402,866
Leke	4,160,502	16,275,106
Euro	2,179	120,982
USD	320	6,778
Totali	25,500,580	25,731,872

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

5. LLOGARI TE ARKETUESHME TREGTARE

Llogarite e arketueshme perbehen nga vlerat e te drejtave ndaj klienteve te Shoqerise te cilet nuk kane shlyer ende detyrimin deri ne daten e ndertimit te pasqyrave financiare. Me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajimet persa i perket klienteve me te medhenj paraqiten si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
NEPTUN Sh.p.k.	43,499,456	36,982,966
KLODIAN SINANI	14,485,624	12,550,424
Arjana Isufi	14,071,742	11,402,048
MEGATEK SH.A	11,843,007	7,978,281
EMILIAN QOSE	10,542,812	-
Ferhat Cullhai	9,208,480	6,434,050
Eco Market Food	7,309,853	81,560
Edil-al-IT	7,106,376	4,147,103
TOP CHANNEL	7,037,128	2,598,188
Artan Goxhaj	6,153,038	-
Eco market sh.p.k	6,136,891	-
LIRIE ALIA	5,139,885	2,130,280
UNIVERS XH & E	5,112,403	5,758,786
BRUNES SHPK	5,003,154	698,913
ELEKTRO-TEK	4,235,473	1,759,214
Lirton Sh.p.k	4,151,247	4,145,731
EURO BEKSHIU SH.P.K	4,134,363	-
Tring TV sha	3,680,080	3,317,470
MIRALDO SHPK	3,486,040	1,099,990
MEGA ELEKTRO sh.p.k	3,257,570	-
Shpetim Shano	3,244,725	-
Notim Kallmeti	3,152,872	141,700
JULIAN HASANAJ	3,135,454	328,200
Te tjere kliente te vegjel	125,652,818	142,723,074
Total	310,780,491	207,295,012

6. TE TJERA LLOGARI TE ARKETUESHME

Te tjera llogari te arketueshme perfshijne vlerat e paguara ne dogane ne fund te periudhes te cilat mbyllen ne fillim te vitit pasardhes si dhe te tjera te drejta ndaj te treteve. Balancat e tyre me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Debitore te tjere(Dogana)	2,822,798	1,353,862
Te tjera te drejta te arketueshme	777,700	884,458
TVSH e arketueshme	-	2,454,486
Total	3,600,498	4,692,806

7. INVENTARI

Inventari me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 perbehet si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Mallra per rishitje (elektroshtepiake)	399,393,573	366,587,750
Mallra per rishitje (ene guzhine)	10,428,801	11,326,471
Te tjera	3,670,635	3,796,745
Parapagime per inventar	11,451,326	4,465,412
Totali	424,944,335	386,176,378

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE

Aktivitet afatgjata materiale dhe jomateriale me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 perfaqesojne sa me poshte:

	Permiresime te objekteve me qera	Mjete transporti	Mobilje & paisje zyre	Paisje informatike	Te tjera aktive	Totali AAM	Software	Totali AAM dhe AAJM
<i>Kosto</i>	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	-	20,509,920	4,954,808	6,262,937	33,000	31,760,665	-	31,760,665
Shtesa	-	1,784,869	951,667	414,166	500,610	3,651,312	-	3,651,312
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	-	22,294,789	5,906,475	6,677,103	533,610	35,411,977	-	35,411,977
Shtesa	2,132,523	4,086,299	1,654,610	693,502	-	8,566,934	2,580,793	11,147,727
Riklasifikim	-	-	-	(472,080)	-	(472,080)	472,080	-
Pakësime	-	(1,922,488)	-	-	-	(1,922,488)	-	(1,922,488)
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	2,132,523	24,458,600	7,561,085	6,898,525	533,610	41,584,343	3,052,873	44,637,216
Amortizimi i akumuluar								
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	-	(11,003,608)	(2,801,987)	(2,909,881)	(7,040)	(16,722,516)	-	(16,722,516)
Shpenzimi i periudhës	-	(1,931,010)	(541,251)	(739,428)	(247,132)	(3,458,821)	-	(3,458,821)
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	-	(12,934,618)	(3,343,238)	(3,649,309)	(254,172)	(20,181,337)	-	(20,181,337)
Shpenzimi i periudhës	-	(2,426,636)	(558,978)	(817,818)	(9,289)	(3,812,721)	(47,389)	(3,860,110)
Riklasifikim	-	-	-	282,523	-	282,523	(282,523)	-
Pakësime	-	1,630,771	-	-	-	1,630,771	-	1,630,771
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	-	(13,730,483)	(3,902,216)	(4,184,604)	(263,461)	(22,080,764)	(329,912)	(22,410,676)
Vlera neto kontabël								
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	-	9,360,171	2,563,237	3,027,794	279,438	15,230,640	-	15,230,640
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	2,132,523	10,728,117	3,658,869	2,713,921	270,149	19,503,579	2,722,961	22,226,540

Mjetet e transportit te Shoqerise jane te financuara me qera financiare (shenimi 10) nga shoqeria Landes Leasing.

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

9. TE TJERA TE DREJTA NDAJ TE TRETEVE

Te tjera te drejta ndaj te treteve perbehet nga vlera nga pale te treta qe ne daten e ndertimit te bilancit nuk kane shlyer detyrimin perkates ndaj Shoqerise dhe kane afat te gjate te pageses se detyrimit. Me 31 dhjetor 2017 e drejta eshte ne vleren prej 21,208,183 leke (31 dhjetor 2016: 40,580,155 leke).

10. HUA AFATSHKURTRA DHE AFATGJATA

Llogaria hua afatshkurtra perfshin llogarite per qerate leasing dhe kredi dhe OVD. Qeraja financiare eshte marre per te financuar mjetet e transportit te Shoqerise (shenimi 8). Vlera totale e detyrimit te mbetur eshte 21,123 EUR ose kundervlefte ne leke prej 2,808,323 leke. Ato mbartin nje norme interesi prej 6% e ndryshueshme cdo vit. Ne hua afatgjate eshte perfshire nje kredi e marre ne banken Intesa Sanpaolo me vlere te mbetur 46,611,363 leke

Huaja afatshkurter perbehet nga overdarfte.

Kjo llogari me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 perbehet si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Pjesa afatshkurter:		
Overdraft	146,245,000	108,820,040
Pjesa afatgjate:		
Qira financiare afatgjate	2,808,323	-
Hua afatgjate	46,611,363	60,956,640
Totali huase afatgjate	49,419,686	60,956,640

11. ARKËTIME NË AVANCE PËR POROSI

Arketime ne avance per porosi perbehet nga vlera te arketuara nga te tretet per porosi te ardhshme per mallra dhe inventare. Me 31 dhjetor 2017 akretimet ne avance jane ne vleren prej 5,075,753 leke (31 dhjetor 2016: 6,253,329 leke).

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

12. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Te pagueshme ndaj furnitoreve perbehet nga vlera per tu paguar per sherbimet, mallrat, etj. por te papaguara ende ne fund te periudhes. Nje detajim me i hollesisem i llogarive te pagueshme me kryesore jepet ne shenimin me poshte.

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Indesit Company	50,929,405	76,174,394
NEPTUN sh.p.k	42,433,896	31,939,452
Indesit Company SPA(Pjese Kembimi)	38,565,967	8,472,937
CANDY-HOOVER GROUP	29,017,601	17,364,073
ARISTON THERMO Group	25,308,793	-
AIBA Sha	20,961,257	19,473,257
B.G.R. Sha	15,904,749	14,878,346
Concord Investment sh.p.k	13,547,057	5,761,373
Top Channel	9,654,094	4,319,453
ELICA SPA	6,776,721	4,992,824
Mersim Xhari	6,660,724	6,660,724
(SINBO)Deima Elektromekanik Urunler Insaat Spor Malz. Imalat		
San.Ve Tic. A.S.	6,541,988	-
Eurobrands shpk	6,158,111	4,554,421
F1054;243;Smart Deal Electrica	6,124,198	-
ALBA-TRADE	6,070,388	4,913,001
ECO MARKET SHPK	5,678,900	3,381,756
ALBITAL CANON SHPK	5,095,407	6,310,092
Universal Media Corporation (Blaunkpunt)	3,923,089	-
FASTECH SHPK	3,864,219	-
Elektro-Tek Sh.p.k	3,544,677	3,022,747
C.Bomann GmbH	3,435,385	2,798,826
Kastriot Perleka	3,353,500	3,353,500
Dixhi print Al sh.p.k	3,276,154	567,629
Te tjere furnitore te vegjel	73,183,849	106,844,015
Totali	390,010,129	325,782,820

13. DETYRIME TATIMORE

Llogaria e detyrimeve tatimore me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 perbehen si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
TVSH e pagueshme	7,263,598	-
Detyrim tatim fitimi	2,912,466	430,089
Detyrim per tatimin ne burim	640,778	420,944
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	628,405	549,229
Tatim mbi te ardhurat personale	21,970	17,420
Totali	11,467,217	1,417,682

14. PROVIZIONE

Provizionet perbehen nga kliente te veshtire per tu mbledhur te cilet jane provigjonuar dhe me date 31 dhjetor 2017 jane ne masen prej 2,714,347 leke.

15. TE TJERA TE PAGUESHME

Te tjera te pagueshme perben detyrimin ndaj ortakeve te Shoqerise qe me date 31 dhjetor 2017 eshte ne masen 80,056,245 leke (31 dhjetor 2016 : 80,057,197 leke).

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

16. TE ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT

Shoqëria siguron te ardhura nga shitja e mallrave industriale, kryesisht elektroshtepiake dhe paisje kuzhine. Nje detajim i te ardhures neto te Shoqerise jepet si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te ardhura nga shitje elektroshtepiake	849,937,561	751,808,763
Te ardhura nga shitje ene guzhine	17,927,551	18,991,966
Te ardhura te tjera te lidhura me operacionet	479,447	2,220,664
Totali	868,344,559	773,021,393

17. LENDA E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME

Lenda e pare dhe te tjera materiale te konsumueshme per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 perbehen si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
KMSH shitje elektro shtepiake	645,996,633	624,513,809
KMSH shitje elene kuzhine	9,809,273	10,391,681
Shpenzime te tjera lidhur me operacionet	46,344,705	1,789,874
Totali	702,150,611	636,695,364

18. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzime te tjera per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 perbehen si me poshte

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime telefoni+intranet	1,224,693	928,512
Energji elektrike e uje	2,726,878	2,345,948
Konsum karburanti	3,844,585	5,339,311
Kanceleri, kataloge, mat.konsumi	6,367,181	5,568,801
Totali	14,163,337	14,182,572

19. SHPENZIME TE TJERA TE SHFRYTEZIMIT

Shpenzime te tjera te shfrytezimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 perbehen si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime per taksa te ndryshme	1,426,089	907,764
Shpenzime mirembajtje e riparime	10,144,691	5,813,739
Shpenzime reklame ,marketing e konsulenca	28,275,956	17,142,649
Shpenzime qeraje	21,512,661	18,135,373
Shpenzime te tjera	16,044,026	29,268,934
Shpenzime bankare	3,721,411	3,390,300
Totali	81,124,834	74,658,759

20. TE ARDHURA TE TJERA

Te ardhura te tjera përfshijnë fitimet nga kurset e kembimit dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 jane ne vleren prej 3,942,157 leke (31 dhjetor 2016: 3,976,357 leke).

21. SHPENZIME FINANCIARE

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit per qirane financiare (shenimi 10) te cilat me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si me poshte:

Shpenzime financiare	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
(Shpenzime) interesi per huate (shenimi 10)	(8,032,478)	(7,629,051)
Totali	(8,032,478)	(7,629,051)

GOTECH SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

22. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Ne perputhje me ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme per tatimin mbi fitimin per periudhen 2017 eshte 15% (31 dhjetor 2016: 15%). Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit, por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar per qellime tatimi jane vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shoqeria per vitin 2017 rezulton me fitim si per qellime kontabile ashtu dhe per qellime fiskale. Nje rikonsilim i tatim fitimit paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	34,141,490	17,540,530
Rregullime per:		
Shpenzime te tjera te pazbritshme	2,882,389	1,016,327
Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)	37,023,879	18,556,857
Tatim fitimi @15%	(5,553,582)	(2,783,529)
Fitimi Neto	28,587,908	14,757,001

23. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta. Me 31 dhjetor 2017, Shoqeria nuk ka çeshtje te cilat do te kene efekte negative ne pozicionin financiar te Shoqeria ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Gjithashtu, me 31 dhjetor 2017, Shoqeria nuk ka angazhime kapitale te kontraktuara por ende te papaguara.

24. NGJARJE TE MEPASSHME

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.